REPUBLIKA E SHQIPËRISË

AUTORITETI I KONKURRENCËS

KOMISIONI KONKURRENCËS

Nr. 278/33 prot.

Tiranë, më 25.09.2023

VENDIM

Nr. 1017, Datë 25.09.2023

"MBI SHQYRTIMIN E ANKIMIMIT ADMINISTRATIV TË SHOQËRIVE AGNA SHA, INFO-TELECOM SHPK DHE TIRANA INTERNATIONAL DEVELOPMENT SHPK, PËR GJOBËN E VENDOSUR PËR MOS NJOFTIMIN BRENDA AFATIT TË PËRQENDRIMIT TË REALIZUAR PËR PËRFTIMIN E KONTROLLIT TË PËRBASHKËT TË SHOQËRISË AMB CONSTRUCTION SHPK"

Komisioni i Konkurrencës me pjesëmarrjen e:

Z.	Denar BIBA	Kryetar
Znj.	Leida MATJA	Zv/Kryetar
Znj.	Rezana KONOMI	Anëtar
Z.	Durim KRAJA	Anëtar

Në mbledhjen e tij të datës 25.09. 2023, shqyrtoi çështjen me:

Objekti: Shqyrtimi i ankimit administrativ së shoqërive AGNA SHA, INFO-Telecom SHPK dhe TIRANA INTERNATIONAL DEVELOPMENT SHPK në lidhje me gjobën e vendosur për mos njoftimin brenda afatit të përqendrimit të realizuar nëpërmjet përftimit të kontrollit të përbashkët mbi shoqërinë AMB Construction SHPK.

Baza Ligjore: Nenet 2, 10-12, neni 24, germa d e ligjit nr. 9121 datë 28.07.2003 "Për mbrojtjen e Konkurrencës"; neni 113, pika 3; nenet 136 e 139, pika 1 të Ligjit nr. 44/2015 "KODI I PROCEDURAVE ADMINISTRATIVE I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË".

Komisioni i Konkurrencës (këtu e në vijim Komisioni), pas shqyrtimit të materialit të Sekretarit të Përgjithshëm "Mbi Ankimin Administrativ të shoqërive AGNA SHA, TIRANA INTERNATIONAL DEVELOPMENT SHPK dhe Info-Telecom SHPK"; dëgjesës me shoqëritë

AMB Construction SHPK nga shoqëritë AGNA SHA, INFO-Telecom SHPK dhe TIRANA INTERNATIONAL DEVELOPMENT SHPK"; si dhe relacionit "Mbi vlerësimin e masës së gjobës vendosur me vendimin nr. 996 datë 05.07.2023 "Për vendosje gjobe ndaj shoqërive AGNA SHA, INFO-Telecom SHPK dhe TIRANA INTERNATIONAL DEVELOPMENT SHPK, për mos njoftimin brenda afatit të përqendrimit të realizuar për përftimin e kontrollit të përbashkët të shoqërisë AMB Construction SHPK", i ndryshuar.",

VËREN SE :

I. Procedura

Komisioni i Konkurrencës pranë Autoritetit të Konkurrencës (këtu e në vijim AK), me vendimin nr.996, datë 05.07.2023, "Për vendosje gjobe ndaj shoqërive AGNA SHA, INFO-Telecom SHPK dhe TIRANA INTERNATIONAL DEVELOPMENT SHPK, për mosnjoftimin brenda afatit të përqendrimit të realizuar për përftimin e kontrollit të përbashkët të shoqërisë AMB Construction SHPK" dhe vendimin nr.1004, datë 20.07.2023, "Për një korrigjim gabimi në përllogaritje të gjobës së vendosur shoqërisë TIRANA INTERNATIONAL DEVELOPMENT SHPK me vendimin e Komisionit të Konkurrencës nr. 996 datë 05.07.2023, "Për vendosje gjobe ndaj shoqërive AGNA SHA, INFO-Telecom SHPK dhe TIRANA INTERNATIONAL DEVELOPMENT SHPK, për mosnjoftimin brenda afatit të përqendrimit të realizuar për përftimin e kontrollit të përbashkët të shoqërisë AMB Construction SHPK", vendosi ndaj shoqërive, palë blerëse në transaksionin e përftimit të kontrollit të përbashkët të shoqërisë AMB Construction SHPK, gjoba në masën lekë ndaj shoqërive AGNA SHA dhe INFO-Telecom SHPK dhe lekë ndaj shoqërisë TIRANA INTERNATIONAL DEVELOPMENT SHPK.

Nëpërmjet shkresës nr.278/17 prot., i AK datë 02.08.2023 "Ankim Administrativ", shoqëritë AGNA SHA, TIRANA INTERNATIONAL DEVELOPMENT SHPK dhe Info-Telecom SHPK, kanë kërkuar nga Komisioni i Konkurrencës *anulimin kryesisht të vendimeve* të mësipërme.

Pasi u njoh me pretendimet e palëve të parashtruara në "Ankimin Administrativ" si më sipër, në datë 12.09.2023, Komisioni i Konkurrencës ftoi në ambientet e tij dhe realizoi një dëgjesë me përfaqësuesit e shoqërive AGNA SHA, TIRANA INTERNATIONAL DEVELOPMENT SHPK dhe Info-Telecom SHPK dhe ndihmësit e tyre avokatë, të cilët në zbatim të Ligjit nr. 44/2015 "KODI I PROCEDURAVE ADMINISTRATIVE I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË", në përfundim i kërkuan Komisionit të Konkurrencës uljen e masës së gjobës.

II. Pretendimet e ankuesve dhe vlerësimi i Komisionit

Në dokumentin nr.278/17 prot., i AK datë 02.08.2023 "Ankim Administrativ", shoqëritë AGNA SHA, TIRANA INTERNATIONAL DEVELOPMENT SHPK dhe Info-Telecom SHPK kanë ngritur një sërë pretendimesh, të cilat gjatë dëgjesës (së regjistruar audio nga Autoriteti i Konkurrencës në dijeni të të gjithë të pranishmëve), u sintetizuan si vijon:

II. i Vendimi i KK nuk ka respektuar parimin e procesit të rregullt ligjor për shkak të mosnjoftimit të subjekteve mbi procedurën administrative.

Pala ankimuese pretendon se *nuk ka asnjë njoftim për ankuesit për procedurën administrative të zhvilluar ndaj tyre në mungesë duke mohuara haptazi çdo element të mbrojtjes së interesave të ligjshme të këtyre subjekteve.*

Komisioni gjykon se pretendimi i shoqërive AGNA SHA, TIRANA INTERNATIONAL DEVELOPMENT SHPK dhe INFO-Telecom SHPK për mos njoftim nuk qëndron dhe, aq më pak ngrihet në një cenim të së drejtës për tu dëgjuar – si element i rëndësishëm i të drejtës për "procesit të rregullt ligjor".

Autoriteti i Konkurrencës, në zbatim të detyrave të tij funksionale, me nismën e tij, me kërkesën e Kuvendit ose me kërkesën e institucioneve rregullatorë përkatës, kryen procedura hetimore, kur vëren shenja të kufizimit apo shtrembërimit të konkurrencës në treg. Në këtë kontekst, gjatë vlerësimit të shkresës nr. 263 datë 05.05.2023 të gazetarit *A.K.*, Autoriteti i Konkurrencës konstatoi se ndërmjet z.Marin Gjonaj dhe shoqërive AGNA SHA, TIRANA INTERNATIONAL DEVELOPMENT SHPK dhe Info-Telecom SHPK, më datë 15.04.2021, është nënshkruar dokumenti "Kontratë shitblerje (Kuote)", e cila ka sjellë si pasojë, *ndryshimin e kontrollit të shoqërisë AMB Construction SHPK.*

Objekti i "Kontratë shitblerje (Kuote)" datë 15.04.2021, ka qenë shitja nga ana e shitësit tek blerësit 100% e kapitalit të shoqërisë AMB Construction SHPK, kapital i cili ndahet në 3 (tre) kuota. Aktualisht shoqëria AGNA SHA, zotëron 40% të kapitalit të shoqërisë AMB Construction SHPK, duke përbërë një kuotë; shoqëria TIRANA INTERNATIONAL DEVELOPMENT SHPK, zotëron 20% të kapitalit të shoqërisë AMB Construction SHPK, të përbërë nga një kuotë dhe shoqëria INFO-Telecom SHPK, zotëron 40% të kapitalit të shoqërisë AMB Construction SHPK, të përbërë nga një kuotë. Për sa më sipër, rezulton të kemi ndryshim kontrolli të shoqërisë nga *kontroll të vetëm në kontroll të përbashkët* të saj duke sjellë dhe ndryshime në vendimmarrje.

Shoqëria AMB Construction SHPK është njoftuar me shkresën nr.248 Prot., datë 10.05.2023 të Autoritetit të Konkurrencës "Mbi fillimin e procedurës së kontrollit të përqendrimit", në të cilën është kërkuar depozitimi i dokumentacionit të plotë, referuar "Kontratës së shitblerjes së (Kuotave)" datë 15.04.2021, e cila ka sjellë si pasojë ndryshimin e kontrollit të shoqërisë AMB Construction SHPK.

Në zbatim të nenit 55 të ligjit nr. 9121/2003, ju kërkua shoqërisë AMB Construction SHPK, si shoqëri e prekur nga transaksioni, të depozitonte dokumentacionin e përcaktuar në Rregulloren "Për zbatimin e procedurave të përqendrimit të ndërmarrjeve" dhe fillimin e procedurave të kontrollit të përqendrimeve nga Autoriteti i Konkurrencës.

Vlerësimi i transaksionit në kuptim të nenit 10, 12 dhe 56 të ligjit është bërë i qartë në vendimin nr. 995, datë 05.07.2023, "Mbi autorizimin e përqendrimit të realizuar nëpërmjet përftimit të kontrollit të përbashkët të shoqërisë AMB Construction SHPK nga shoqëritë AGNA SHA, INFO-Telecom SHPK dhe TIRANA INTERNATIONAL DEVELOPMENT SHPK", vendim i cili nuk është ankimuar nga ana e palës ankimuese (palët pjesëmarrëse në transaksion).

Dorëzimi i dokumentacionit pranë AK për këtë procedurë është kryer nga shoqëria AMB Construction SHPK, me shkresën nr. 278/1 prot., i AK, datë 25.05.2023, "Përcjellja e formularit

të përqendrimit dhe dokumentacionit", i cili përmban dokumente që i përkasin shoqërive blerëse, fakt i cili rrëzon pretendimin e palës ankimuese për mosnjoftim të procesit administrativ.

Pretendimi i shoqërive AGNA SHA, TIRANA INTERNATIONAL DEVELOPMENT SHPK dhe INFO-Telecom SHPK për mosnjoftim nuk qëndron, pasi në zbatim të nenit 39 ("E drejta e palëve për t'u dëgjuar") të ligjit nr. 9121 datë 28.07.2023 "Për mbrojtjen e konkurrencës" dhe nenit 20 ("Seanca dëgjimore") të Rregullores "Për zbatimin e procedurave të përqendrimit ndërmjet ndërmarrjeve",[1] Komisioni i Konkurrencës u krijon mundësi palëve njoftuese dhe palëve të interesuara të paraqesin verbalisht argumentet e tyre në një seancë dëgjimi, *nëse e kanë kërkuar këtë gjë në komentet e tyre me shkrim dhe nëse ato janë të interesuara.*

Shoqëritë AGNA SHA, TIRANA INTERNATIONAL DEVELOPMENT SHPK dhe INFO-Telecom SHPK, në asnjë moment nuk kanë shprehur interesimin për t'u paraqitur në një seancë dëgjimore pranë Autoritetit të Konkurrencës edhe pse shoqëria e zotëruar prej tyre AMB Construction SHPK[2] ka marrë dijeni shkresërisht se mosnjoftimi i një transaksioni sipas neneve 10 dhe 12 të ligjit, përbën kundërvajtje administrative dhe sanksionohet më gjobë.

Komisioni vlerëson të theksojë gjithashtu se, vendimmarrja në fjalë, ndryshe nga raste të tjera kur ky Komision vendos në lidhje me marrëveshje të ndaluara (neni 4 i ligjit nr. 9121 datë 28.07.2023 "Për mbrojtjen e konkurrencës") apo abuzimin me pozitën dominuese të një ndërmarrje (neni 9 i ligjit nr. 9121 datë 28.07.2023 "Për mbrojtjen e konkurrencës"), ka të bëjë ekskluzivisht me një fakt të kryer e lehtësisht të provueshëm bazuar ekskluzivisht në prova shkresore, të cilat, në këtë rast, iu dorëzuan Komisionit nga vetë ndërmarrja e marrë nën kontroll.

Ligji nr. 9121 datë 28.07.2023 "Për mbrojtjen e konkurrencës", të paktën në lidhje me konceptin e përqendrimit, është i kuptueshëm për këdo, pavarësisht edukimit juridik ose jo kur, përmes nenit 10 parashikon se:

> "Përqendrim të ndërmarrjeve kemi në rastet kur shkaktohet **një ndryshim i qëndrueshëm i kontrollit**,[3] si rrjedhojë e: 1) [...], b) përfitimit të kontrollit të drejtpërdrejtë ose të tërthortë, [...] nga një ose më shumë ndërmarrje, mbi një ose më shumë ndërmarrje, ose të një pjese të këtyre të fundit, përmes blerjes së aksioneve, kuotave apo aseteve, kontratës ose çdo mjeti tjetër të ligjshëm; [...]."

Në rastin e shitjes së 100% të kapitalit të shoqërisë AMB Construction SHPK nga aksioneri i vetëm, z. Marin Gjonaj te shoqëritë AGNA SHA (40% të kapitalit të shoqërisë AMB Construction SHPK, duke përbërë një kuotë), TIRANA INTERNATIONAL DEVELOPMENT SHPK (20% të

---

[1] Neni 20, pika 1: "Komisioni u krijon mundësi palëve njoftuese dhe palëve të interesuar që të paraqesin verbalisht argumentet e tyre në një seancë dëgjimi, **nëse e kanë kërkuar këtë gjë në komentet e tyre me shkrim dhe nëse ato janë të interesuara**."

[2] Shkresa nr.278, prot, datë 10.05.2023.

[3] Ligji, që të ndodhë një përqendrim, nuk kërkon **fitimin** e "një kontrolli të qëndrueshëm" nga një apo më shumë ndërmarrje! Në këtë kuptim, përfitimi i kontrollit mund të jetë i drejtpërdrejtë ose i tërthortë, nga një ose shumë ndërmarrje. Çfarë shkakton një përqendrim është **ndryshimi** (humbja) e qëndrueshme e kontrollit nga ndërmarrja, aksionet, kuotat apo asetet e së cilës blihen nga një, dy apo edhe dhjetëra ndërmarrje të tjera.
Nëse ky përqendrim është "i njoftueshëm" ose jo, kjo sqarohet nga neni 12 i ligjit nr. 9121 datë 28.07.2023 "Për mbrojtjen e konkurrencës" dhe ka të bëjë posaçërisht me xhirot respektive të ndërmarrjeve që marrin pjesë në përqendrim.

kapitalit të shoqërisë AMB Construction SHPK, duke përbërë një kuotë) dhe shoqëria INFO-Telecom SHPK (40% të kapitalit të shoqërisë AMB Construction SHPK, duke përbërë një kuotë), dhe njohja me dokumentacionin përkatës të ofruar nga shoqëria AMB Construction SHPK me kërkesë të AK, konkluzioni se ndodhemi përpara një "ndryshimi të qëndrueshëm të kontrollit" të kësaj shoqërie e, rrjedhimisht përpara një përqendrimi, është në këtë rast si teorikisht ashtu dhe praktikisht i padebatueshëm gojarisht apo me shkresa, pavarësisht njohjes ose jo të ligjit "Për mbrojtjen e konkurrencës" nga ana ndërmarrjeve që përfituan kontrollin.

Akoma më tej, ky ligj është po aq lehtësisht i kuptueshëm kur tekstualisht parashikon se " Kanë detyrimin për njoftim: b) **ndërmarrjet që marrin nën kontroll të gjithë ose pjesë** të një ose më shumë ndërmarrjeve të tjera" (neni 54).

Sidoqoftë, dëgjesa e zhvilluar në datë 12.09.2023 në ambientet e AK praktikisht riparoi edhe çdo problematikë të mundshme në kuptim të procesit të rregullt, duke qenë se thelbi i interesit të palëve të interesuar nuk është një "procesi i rregullt" si abstraksion juridik, por rishikimi i vlerës së gjobave respektive, çka u shpreh më se njëherë dhe shumë qartë nga përfaqësuesit e shoqërive AGNA SHA, TIRANA INTERNATIONAL DEVELOPMENT SHPK dhe Info-Telecom SHPK.

Në lidhje me këtë interes thelbësor, bazuar te neni 113 i KPrA, Komisioni ka kompetencë të plotë të vendosë duke rishikuar vendimmarrjen e mëhershme, për të analizuar pretendimin për mungesë të proporcionalitetit të gjobës me shkeljen e kryer nga ndërmarrjet e hetuara.

II. ii. Dënimi administrativ i vendosur me VKK- objekt ankimi është i paligjshëm për shkak të mungesës së proporcionalitetit dhe mungesës së arsyetimit të individualizimit të tij.

Pala ankimuese pretendon se: *"masa e gjobës është e paligjshme kryesisht për shkak të mos arsyetimit të mënyrës së vendosjes së tyre dhe mungesës së proporcionalitetit mes masës së gjobës dhe shkeljes së pretenduar. ...gjoba e vendosur nga KK, më tepër se sensibilizim i subjekteve lidhur me detyrimin për njoftim, duket se ka shërbyer si "masë ndëshkuese" për ta në raport me fuqinë e tyre ekonomike. Pavarësisht nga sa më sipër dhe pavarësisht se transaksioni objekt hetimi administrativ nuk kishte asnjë pasojë në treg, KK ka aplikuar nivelin më të lartë të gjobës në praktiken e tij. Mendojmë se kjo masë është joproporcionale dhe për faktin se shkelja e pretenduar, në raport me te gjitha shkeljet e tjera që konsiderohen "kundërvajtje" nga ligji nr.9121, është e shkallës më të lehtë.*

Komisioni i Konkurrencës, në zbatim të nenit 12, pika 2, nenit 26 germa d) nenit 53 dhe nenit 73, pika 1 germa dh), miratoi vendimin nr. 996, datë 05.07.2023, "Për vendosje gjobe ndaj shoqërive AGNA SHA, INFO-Telecom SHPK dhe TIRANA INTERNATIONAL DEVELOPMENT SHPK, për mosnjoftimin brenda afatit të përqendrimit të realizuar për përftimin e kontrollit të përbashkët të shoqërisë AMB Construction SHPK" dhe vendimin nr.1004, datë 20.07.2023, "Për një korrigjim gabimi në përllogaritje të gjobës së vendosur shoqërisë TIRANA INTERNATIONAL DEVELOPMENT SHPK me vendimin e Komisionit të Konkurrencës nr. 996 datë 05.07.2023, "Për vendosje gjobe ndaj shoqërive AGNA SHA, INFO-Telecom SHPK dhe TIRANA INTERNATIONAL DEVELOPMENT SHPK, për mosnjoftimin brenda afatit të përqendrimit të realizuar për përftimin e kontrollit të përbashkët të shoqërisë AMB Construction SHPK"

Shkelja administrative në fjalë, sipas neni 73, pika 1, germa dh) e ligjit nr. 9121/2003 klasifikohet si "shkelje e lehtë" dhe sanksionohet më gjobë, "në masën **jo më shumë se 1% e xhiros totale të vitit paraardhës financiar, mbi ndërmarrjet <u>ose grupimet e ndërmarrjeve</u> nëse ... nuk njofton një përqendrim, sipas neneve 10 dhe 12 të këtij ligji**".

Bazuar në rregulloren "Për gjobat dhe lehtësimin prej tyre", në vendimet e Komisionit Evropian dhe autoritetet homologe, për vendosje gjobe për mosnjoftim të një përqendrimi[4], por edhe në raste të trajtuara dhe sanksionuara nga Komisioni Shqiptar i Konkurrencës[5], në përllogaritjen e gjobës janë marrë në konsideratë rrethanat renduese dhe lehtësuese të rastit, të cilat përcaktojnë masën në përqindje të llogaritjes së gjobës dhe konkretisht:

- Njoftimi është bërë me iniciativën e Autoritetit te Konkurrencës %
- Njoftimi është kryer pasi ka kaluar 6 muaj nga parashikimi i nenit 12/2 i Ligjit, %
- Përqendrimi vlerësohet si përqendrim konglomerat %

Mbi këta tregues, përqindja për llogaritjen e gjobës do të ishte %.

Baza e llogaritjes së gjobës vlerësohet sipas parashikimit të nenit 15 të ligjit nr. 9121/2003, pas zbritjes së tatimeve, taksave dhe tarifave të tjera që lidhen drejtpërdrejtë me xhiron e ndërmarrjeve.

Mbështetur në pasqyrat financiare të tre shoqërive blerëse, xhiroja e tre shoqërive së bashku, për efekt vlerësimit të gjobës është lekë, sipas tabelës së mëposhtme:

	AGNA	**TID**	**Info Telecom**	**Totali i shoqërive**
Xhirot e vitit 2020				
Zbritje tatime dhe taksa				
tatim fitimi				
taksa doganore*				

[4] Autoriteti i Konkurrencës së Spanjës, vendosi të 1.5milion euro për ekzekutimin e një përqendrimi përpara autorizimit nga Komisioni i Konkurrencës në rastin XFERA MÓVILES

Rasti The Illumina/GRAIL, dhjetor 2022 https://ec.europa.eu/commission/presscorner/detail/en/ip_23_3773

https://www.squirepattonboggs.com/-/media/files/insights/publications/2013/07/merger-control-notification-penalties-for failur__/files/mergercontrolnotificationpenaltiesforfailuretono__/fileattachment/mergercontrolnotificationpenaltiesforfailuretono__.pdf

[5] Vendimi Nr. 504, datë 29.03.2018 "Mbi përftimin e kontrollit të shoqërisë VALTELINA SHPK nga shoqëria ALB-ERK SHPK" vendosi gjobë në masën 971,200 lekë ndaj shoqërisë ALB-ERK SHPK; Vendimi nr. 758, datë 28.12.2020 "Mbi autorizimin e përqendrimit të realizuar nëpërmjet përftimit të kontrollit të shoqërisë ApNet SHPK nga shoqëria ABCom SHPK", vendosi gjobë në masën 3,986,270 lekë ndaj shoqërisë ABCom SHPK; Vendimi nr. 993, datë 08.06.2023, KK vendosi gjobë mbi shoqërinë GEGA OIL GROUP SHA, në masën 5.000.000 lekë, për mos njoftimin brenda afatit të përqendrimit të realizuar nëpërmjet bashkimit me përthithje të shoqërisë Gega Oil SHA nga shoqëria Genklaudis SHA; vendimi nr. 1005, datë 28.07.2023, KK vendosi të gjobisë shoqërinë AIR BP ALBANIA SHA në masën 3,000,000 lekë për depozitim të të dhënave të paplota dhe të pasakta në kuptim të nenit 55 të ligjit nr. 9121/2003 "Për mbrojtjen e konkurrencës".

te tjera tatime taksa**				
autofaturim***				
Xhiroja pas zbritjes se taksa/tatime				
Fitimi/humbje				
Aplikimi I gjobes/ koef 0,35%				
Gjoba Max 1%				
Gjoba e vene				
Përqindja ndaj xhiros				

Komisioni e gjen korrekt deduksionin e palëve ankuese se, në këtë rast, vlera e gjobës në lek si në total për të treja ndërmarrjet ashtu edhe individualisht për ndërmarrjet AGNA SHA dhe INFO-Telecom SHPK është më e larta në historinë 20 vjeçare të institucionit; në përqindje, vlera e gjobës për ndërmarrjen TIRANA INTERNATIONAL DEVELOPMENT SHPK është jo vetëm më e larta e vendosur ndonjëherë, por edhe fare afër kufirit të epërm të parashikuar nga ligji.

Nga ana tjetër, përqindja e gjobës bazuar te xhiroja e "grupimit të ndërmarrjeve"[6] për vitin 2020 si viti pararendës me periudhën kur ka ndodhur shkelja, në respekt të Rregullores së AK "Për gjobat dhe lehtësimin prej tyre" rezulton në vlerën %, që shënoi dhe pikën se nga nisi arsyetimin Komisioni i Konkurrencës për të gjobitur me lek ndërmarrjet AGNA SHA dhe INFO-Telecom SHPK dhe me lek ndërmarrjen TIRANA INTERNATIONAL DEVELOPMENT SHPK.

Rregullorja "Për gjobat dhe lehtësimin prej tyre", e miratuar me Vendimin e Komisionit të Konkurrencës nr.120, datë 10.09.2009, ndryshe nga sa pretendojnë palët, nuk është një rregullore që parashikon posaçërisht e vetëm për masat e gjobës për shkeljet e rënda (neni 74 i ligjit nr. 9121 datë 28.07.2023 "Për mbrojtjen e konkurrencës". Kjo nuk thuhet apo nënkuptohet nga asnjë nen i kësaj rregullore dhe është një keqkuptim i palëve, i ardhur ndoshta nga mosnjohja e këtij akti nënligjor dhe/ose nga ndikimi i jurisprudencës së AK që, në lidhje me gjobat, është shumë herë më e pasur në lidhje me shkelje të rënda (marrëveshje të ndaluara apo abuzim me pozitën dominuese) sesa me shkelje të lehta (ku hyn edhe mosnjoftimi i një përqendrimi).

Pavarësisht kësaj, Komisioni thekson se, në rastin në analizë, kemi të bëjmë me një përqendrim konglomerat, për të cilin, në dallim nga përqendrimet horizontale apo vertikale, është e pamundur të identifikohet "tregu përkatës" e, rrjedhimisht të respektohet plotësisht Rregullorja "Për gjobat dhe lehtësimin prej tyre", e cila në nenin 4 të saj kërkon përcaktimin e vlerës bazë të gjobës "në

[6] Një term i njohur nga ligji nr. 9121/2003

tregun përkatës". Kjo *lacuna legis* ka krijuar tek palët dyshimin se masat e gjobave nuk kanë qenë të individualizuara dhe proporcionale.

Në këtë pikë, Komisioni, duke e marrë parasysh gjithë sa më lart, sidoqoftë vlerëson të theksojë se, masat e gjobave në përqindje ( ) janë në çdo rast brenda parashikimit të nenit 73 të ligjit ("**jo më shumë se 1% të xhiros totale** të vitit paraardhës financiar mbi ndërmarrjet ose grupimet e ndërmarrjeve") dhe se, në vlerë reale në Lekë, në vendimin e Komisionit nr. 996 datë 05.07.2023 "Për vendosje gjobe ndaj shoqërive AGNA SHA, INFO-Telecom SHPK dhe TIRANA INTERNATIONAL DEVELOPMENT SHPK, për mos njoftimin brenda afatit të përqendrimit të realizuar për përftimin e kontrollit të përbashkët të shoqërisë AMB Construction SHPK" është pasur parasysh pjesëmarrja në përqindje e këtyre tre ndërmarrjeve në ndërmarrjen AMB Construction SHPK.

II. iii. Aktet administrative bazohen në të dhëna të administruara e të analizuara në mënyrë të pasaktë.

Palët në ankim pretendojnë se *aktet administrative bazohen në të dhëna të administruara e të analizuara në mënyrë të pasaktë dhe se në rastin në analizë është e pamundur të argumentohet se ka ndodhur ndonjë ndryshim thelbësor në strukturën e shoqërisë apo të tregut.*

Autoriteti i Konkurrencës ka administruar dhe ka realizuar procedurën e kontrollit të përqendrimit vetëm mbi dokumentacionin e depozituar nga shoqëria AMB Construction SHPK, me shkresën nr. 278/1 prot., i AK, datë 25.05.2023, "Përcjellja e formularit të përqendrimit dhe dokumentacionit".

Në zbatim të ligjit, Komisioni i Konkurrencës autorizon ato transaksione të cilat nuk krijojnë apo forcojnë pozitën dominuese në treg (neni 56, pika 1 e ligjit) dhe në rast evidentimi të forcimit apo krijimit të pozitës dominuese, Komisioni vendos të autorizojë përqendrimin me kushte dhe detyrime sipas parashikimit të nenit 61 ose fillon procedurën e thelluar sipas parashikimit të nenit 57 të ligjit.

Transaksioni i mësipërm u klasifikua si një transaksion konglomerat, i cili nuk krijonte apo forconte pozitën dominuese dhe, për këto arsye, Komisioni i Konkurrencës me vendimin nr. 995, datë 05.07.2023, "Mbi autorizimin e përqendrimit të realizuar nëpërmjet përftimit të kontrollit të përbashkët të shoqërisë AMB Construction SHPK nga shoqëritë AGNA SHA, INFO-Telecom SHPK dhe TIRANA INTERNATIONAL DEVELOPMENT SHPK", vendosi autorizimin e këtij përqendrimi.

Ndryshimi i kontrollit të shoqërisë AMB Construction SHPK është një fakt i pakontestueshëm, i pranuar tashmë edhe nga palët ankuese gjatë dëgjesës dhe procedura e kontrollit është realizuar në zbatim të neneve 53-64 të ligjit dhe akteve të tjera nënligjore.

III. Vlerësimi i Komisionit

Komisioni i Konkurrencës me vendimin nr.995, datë 05.07.2023, "Mbi autorizimin e përqendrimit të realizuar nëpërmjet përftimit të kontrollit të përbashkët të shoqërisë AMB Construction SHPK

nga shoqëritë AGNA SHA, INFO-Telecom SHPK dhe TIRANA INTERNATIONAL DEVELOPMENT SHPK", vendosi të autorizojë ndryshimin e kontrollit të shoqërisë AMB Construction SHPK.

Për mosrespektim të nenit 12, pika 2 dhe nenit 53 të ligjit nr. 9121/2003 "Për mbrojtjen e konkurrencës", shoqëritë AGNA SHA, TIRANA INTERNATIONAL DEVELOPMENT SHPK dhe Info-Telecom SHPK u gjobitën sipas parashikimit të nenit 73, pika 1 gërma "dh" e ligjit.

Nëpërmjet shkresës nr.278/17 prot., i AK datë 02.08.2023 "Ankim Administrativ", shoqëritë AGNA SHA, TIRANA INTERNATIONAL DEVELOPMENT SHPK dhe Info-Telecom SHPK, kanë kërkuar nga Komisioni i Konkurrencës *anulimin kryesisht* të:

- vendimit nr. 996, datë 05.07.2023, "Për vendosje gjobe ndaj shoqërive AGNA SHA, INFO-Telecom SHPK dhe TIRANA INTERNATIONAL DEVELOPMENT SHPK, për mosnjoftimin brenda afatit të përqendrimit të realizuar për përftimin e kontrollit të përbashkët të shoqërisë AMB Construction SHPK" dhe,

- vendimin nr.1004, datë 20.07.2023, "Për një korrigjim gabimi në përllogaritje të gjobës së vendosur shoqërisë TIRANA INTERNATIONAL DEVELOPMENT SHPK me vendimin e Komisionit të Konkurrencës nr. 996 datë 05.07.2023, "Për vendosje gjobe ndaj shoqërive AGNA SHA, INFO-Telecom SHPK dhe TIRANA INTERNATIONAL DEVELOPMENT SHPK, për mosnjoftimin brenda afatit të përqendrimit të realizuar për përftimin e kontrollit të përbashkët të shoqërisë AMB Construction SHPK".

Gjatë dëgjesës palët pranuan faktin që transaksioni i përftimit të kontrollit të përbashkët të shoqërisë AMB Construction SHPK nga shoqëritë AGNA SHA, INFO-Telecom SHPK dhe TIRANA INTERNATIONAL DEVELOPMENT SHPK përbënte një përqendrim në kuptim të nenit 10 dhe 12 të ligjit dhe si i tillë duhej të njoftohej pranë Autoritetit të Konkurrencës. Sipas tyre, ato kishin gjykuar se transaksioni nuk do të sillte efekte në treg dhe për këto arsye nuk është njoftuar pranë Autoritetit të Konkurrencës. Palët pretendojnë se gjoba e vendosur në kuptim të nenit 73, pika 1 germa dh) e ligjit është jo proporcionale dhe e lartë krahasuar me gjobat e vendosura nga Komisioni i Konkurrencës në vite, për të njëjtën shkelje.

Në zbatim të ligjit nr. 44/2015 "KODI I PROCEDURAVE ADMINISTRATIVE I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË", pala ankimuese kërkoi gjatë dëgjesës rishikimin e masës së gjobës, me qëllim që kjo masë të jetë proporcionale dhe e arsyeshme me shkeljen dhe pasojat e saj.

Nga vlerësimi i pretendimeve te palës ankimuese, Komisioni i Konkurrencës konstaton se:

- Vendosja e sanksioneve administrative, të parashikuara në nenin 73, pika 1 e ligjit përcaktohen si gjoba të lehta, procedurale, të cilat kanë të bëjnë me ndërgjegjësimin e ndërmarrjeve në treg për njohjen dhe respektimin e Autoritetit të Konkurrencës, si dhe zbatimin e rregullave të konkurrencës. Mosnjohja e ligjit nuk është argument për mosrespektimin e tij! Për më tepër, ndërmarrje të mëdha dhe të konsoliduara në treg i kanë të gjitha mundësitë financiare dhe menaxheriale që të krijojnë struktura permanente që do të mbikëqyrin përputhshmërinë e veprimeve të ndërmarrjeve me ligjin dhe/ose të kontraktimit të studiove legale që do të sigurojnë njohjen dhe respektimin e ligjit dhe rregullave të konkurrencës.

- Sanksioni administrativ në të drejtën e konkurrencës synon, sa ndëshkimin e mosrespektimit të ligjit, aq edhe parandalimin e shkeljeve të tjera nga subjekti i ndëshkuar apo subjekte të tjerë që operojnë në treg.
- Masa e gjobës e vendosur ndaj shoqërive AGNA SHA dhe INFO-Telecom SHPK me vendimin nr. 996, datë 05.07.2023 përbën % të xhiros së vitin 2020, ndërkohë që gjoba e vendosur ndaj TIRANA INTERNATIONAL DEVELOPMENT SHPK përbën % e xhiros së shoqërisë. Mbështetur në parimin e proporcionalitetit, Komisioni i Konkurrencës gjykon se, në këtë rast, të tre shoqëritë duhet të sanksionohen në mënyrë të njëjtë duke mos rënduar pozitën e ndërmarrjeve të gjobitura me përqindjen më të ulët, por duke ulur përqindjen e gjobës edhe për ndërmarrjen TIRANA INTERNATIONAL DEVELOPMENT SHPK, sjellja e së cilës nuk ndryshon në asnjë detaj nga sjelljet e dy ndërmarrjeve të tjera.
- Mbështetur në statistikat e deritanishme të gjobave, të vendosura nga Komisioni i Konkurrencës për shkelje te nenit 73 pika 1 germa dh) e ligjit, për mosnjoftim të një përqendrimi sipas parashikimit të nenit 12, pika 2 e tij, Komisioni i Konkurrencës konstaton se gjoba e vendosur për tre shoqëritë është me disa herë më e larta për shkelje të ngjashme. Nga ana tjetër, Komisioni me keqardhje vëren se, niveli i gjobave të vendosura në periudhën nga krijimi i AK e deri në vitin 2018 nuk ia ka dalë në parandalimin e shkeljes ligjore në analizë.
- Duke rimarrë në konsideratë frymën e ligjit, i cili e konsideron shkeljen në fjalë si "të lehtë", sensibilizimin dhe pranimin e plotë të shkeljes nga palët e përfshira në këtë transaksion, efektet financiare të gjobave përkatëse dhe faktin që rezultoi nga dëgjesa se ky transaksion nuk ka sjellë asnjë efekt në treg, Komisioni i Konkurrencës gjykon se në zbatim të nenit 113, pika 3 të Kodit të Procedurave Administrative të ndryshojë masën e gjobës ndaj shoqërive AGNA SHA, INFO-Telecom SHPK dhe TIRANA INTERNATIONAL DEVELOPMENT SHPK, duke e sjellë në koherencë me rastet më të fundit të ngjashme, por në mënyrë konsekuente në ngritje, për të siguruar që sanksionet e vendosura do të shërbejnë për të parandaluar sa të jetë e mundur shkeljen e ligjit.

PËR KËTO ARSYE:

Komisioni i Konkurrencës, në bazë të nenit 24, shkronja d) të ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 "Për mbrojtjen e konkurrencës" dhe nenit 113, pika 3; nenet 136 e 139, pika 1 të ligjit nr. 44/2015 "KODI I PROCEDURAVE ADMINISTRATIVE I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË",

VENDOSI:

1. Të ndryshohet pika 1 germa a); b) dhe c) e vendimi nr. 996 datë 05.07.2023 "Për vendosje gjobe ndaj shoqërive AGNA SHA, INFO-Telecom SHPK dhe TIRANA INTERNATIONAL DEVELOPMENT SHPK, për mos njoftimin brenda afatit të përqendrimit të realizuar për përftimin e kontrollit të përbashkët të shoqërisë AMB Construction SHPK": si më poshtë:

a) shoqërinë AGNA SHA, në masën 0.05% të xhiros financiare së vitit 2020, në vlerën 7,161,174 (shtatë milion e njëqind e gjashtëdhjetë e një mijë e njëqind e shtatëdhjetë e katër) lekë,

b) shoqërinë INFO-Telecom SHPK, në masën 0.05% të xhiros financiare së vitit 2020, në vlerën 7,099,578 (shtatë milion e nëntëdhjetë e nëntë mije e pesëqind e shtatëdhjetë e katër) lekë,

c) shoqërinë TIRANA INTERNATIONAL DEVELOPMENT SHPK SHPK, në masën 0.05% të xhiros financiare së vitit 2020, në vlerën 253,814 (dyqind e pesëdhjetë e tre mijë e tetëqind e katërmbëdhjetë) lekë

2. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim pranë Gjykatës Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve nga data e marrjes së njoftimit të vendimin.

3. Ngarkohet Sekretariati për njoftimin e palëve.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I KONKURRENCËS

Leida MATJA
(_____)
Zv/Kryetar

Rezana KONOMI
(_____)
Anëtar

Durim KRAJA
(_____)
Anëtar

Denar BIBA
(_____)
Kryetar

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I KONKURRENCËS